REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:079302
Datë: 13.07.2021
Numri i dokumentit: 01990600

C.nr.1425/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirvete Alidema, duke vendosur në çështjen kontestuese të paditësit M. M. nga Gjilani rruga e " .... " numër ..., të cilin me autorizim e përfaqëson Shabi Isufi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, në Gjilan të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bardhosh Dalipi avokat nga Gjilani, për kompensimin e dëmit material, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 25 Qershor 2021 , përpiloi me shkrim këtë:

A K T GJ Y K I M

I.MIRATOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit M. M. nga Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura-Komuna e Gjilanit t'ia kompensoj demin material në emër te investimeve te kryera për renovimin-rregullimin e hapësirës së korridorit të shkollës dhe rregullimin e lokalit afarist për kafe-byfe, në Shkollën e Mesme Teknike "Mehmet Isai" në Gjilan, të llogaritur në lartësinë prej 8.458,90euro, me kamat vjetore që do të llogaritet prej 3.5%, sa paguajnë qytetarët në bankat afariste të Republikës së Kosovës, nga data 06.04.2007 (data e dorëzimit të padisë në Gjykatë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm .

II. Secila palë paraprakisht vet i bart harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta .

A r s y e t i m

Paditësi M. M. nga Gjilani, në këtë gjykatë me datë 06.04.2007 ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit.

Gjykata Themelore në Gjilan me Aktgjykimin e datën 05.11.2014 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit M. M. ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë duke vendosur sipas ankesë së të paditurës, me Aktvendimin Ac.nr.29/2015 të dt.12.05.2020 e ka prishur aktgjykimin e kësaj gjykate dhe lëndën e kthyer në rigjykim gjegjësisht në rivendosje.

Lidhur me këtë çështje kontestuese, gjykata ka caktuar shqyrtimet gjyqësore , në të cilën seancë i autorizuari i paditësit , ka deklarua që mbetet në tërësi si në padisë dhe në rregullimin e padisë të bërë më datën 05.11.2015, duke shtuar se Komuna e Gjilanit në kuadër të së cilës është edhe Shkolla e Mesme Teknike "Mehmet Isai" në Gjilan, e ka larguar paditësin nga lokali afarist me procedurë ekzekutimit në vitin 2006 kështu që investimet e bëra nga paditësi në rregullimin e lokalit dhe korridorit të shkollës kanë shkuar kot dhe të njëjtit i është shkaktuar dëm material të cilin me të drejtë e kërkon. Ka shtuar që lokali afarist është lëshuar në bazë të tenderit të shpallur më datën 10.01.2002 të cilin e kishte fituar paditësi, në të cilin tender kishin marrë pjesë edhe persona të tjerë. Pasi që lokali-byfeja ishte në gjendje të mjerë në bodrumin e shkollë së Mesme "Mehmet Isai" me pajtimin e përbashkët paditësi kishte bërë investime në renovimin e lokalit-byfesë së bashku me korridorin që përfshin sipërfaqen prej 429 m2. Renovimi ishte bërë me lejen e shkollës sepse është absurde të mendohet se paditësi ka mund të kryej -rinovoj podrumin dhe korridorin për të shërbyer si kafene e shkollës. Shpenzimet e shkaktuar për renovim ishin vërtetuar nga komisioni i caktuar nga shkolla . Pas renovimit të lokalit afarist paditësi kishte punuar vetëm 10 ditë, pasi kishte ndodhur tërmeti me datën 24.04.2002 dhe pastaj nuk ishte punuar në këtë shkollë për shkak të dëmeve të shkaktuara nga tërmet deri në vitin 2004 , ndërsa mësimi ishte mbajtur në shkollën e fshatin Livoq. Në vitin 2004 kishin filluar punën vetëm 4 paralele dhe atë në katin e parë, ndërsa pjesa tjetër të objektit të shkollës ishte ndaluar të veprohet e që shikuar në mënyrë analoge nuk kishte funksionuar as lokali afarist. E kjo mund të dëshmohet me faktin se paditësi nuk ka kurrfarë tatimi sepse nuk ka punuar. Paditësi disa herë kishte paraqitur kërkesa te Këshilli i Shkollë për ti vërtetuar investimet e bëra në kafene e shkollës. Këshilli i shkollës kishte formuar komisionin dhe i kishte vërtetuar investimet të cilat më vonë ishin vërtetuan edhe me ekspertizën të kryer nga eksperti i caktuar nga gjykata, me të cilën ishte vërtetuar se paditësi sa i përket punëve në rregullimin e lokalit- kafenesë dhe korridor sipas ekspertizës edhe pse ishin më të mëdha ka, kërkuar vetëm 7,313.90€ dhe shumën për rregullimin e energjisë elektrike që ishte prej 1,145.00€, gjithsej shuma e shpenzuar ishte prej 8,458.90€. Pasi që i njëjti nuk kishte arritur që të punoj fare në kafenenë e shkollës edhe pse kishte investuar në të, e paditur kishte paraqitur propozim për lirimin e lokalit në fjalë nga njerëzit dhe sendet , të cilin lokalin e kishte liruar më datën 07.11.2006 dhe kështu qe paditësit i është shkaktuar dëm material për shpenzimet e bëra dhe tani me të drejtë i kërkon kompensimin e shpenzimeve të shkaktuar për të. I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të aprovohet kërkesëpadia në tërësi si të bazuar dhe gjykata ta detyroi të paditurën që në emër të dëmit të pësuar për rregullimin e lokalit t'ia kompensoj shumën prej 8,458.00€ , për dëmin material gjegjësisht për investimet e bëra në rregullin e lokalit - byfesë për nevojat e nxënësve dhe arsimtarëve të shkollës. I ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës edhe atë sipas aktgjykimit C.nr.385/12 shumën prej 1.466.00€ si dhe shpenzimet për përgjigje në ankesën e paraqitur edhe për dy seanca të mbajtura shumën prej 405, gjithsej në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 1,871.00€.

I autorizuari i të padituerës si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar që mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim që edhe pas riprocedimit të kësaj çështje kontestuese, sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj, nuk është paraqitur ndonjë provë e re nga paditësi e cila do të kishte qenë relevante për ta vërtetuar besueshmërinë e kërkesëpadisë siç jemi deklaruar edhe përgjigjen më padi. Paditësi në rastin konkret nuk ka pësuar ndonjë dëm ashtu siç pretendon nga shfrytëzimi i lokalit të shkollë si kafene por konsideron se përkundrazi i njëjti duke e shfrytëzuar këtë lokal për 6 vite me radhë vetëm sa ka përfituar ndërsa asnjë cent në këtë drejtim nuk është paguar në Fondin e Shkollës edhe pse sipas marrëveshjes gojore kishte thënë që paditësi këtë lokal ta shfrytëzoj dy vite dhe shkollës t'ia paguaj 30% nga vlera e qirasë për 200 € në muaj kurse pjesa tjetër prej 70% sipas marrëveshjes për nevojat e shkollës. Kjo marrëveshje e dt.08.02.2002 ishte përpiluar me shkrim nga Këshilli i Shkollës por paditësi ka refuzuar që ta nënshkruar dhe megjithatë ka filluar shfrytëzimin e lokalit si kafene. Po ashtu ka shtuar se eksperti i ndërtimtarisë në ekspertizën e datës 17 korrik 2014 ka konstatuar se ndër të tjera , punët për rregullimin e hapësirës së shkollës për kafene-byftë kishin filluar pa një kontratë të formës së shkruar dhe se gjatë periudhës së punës së bufesë fare nuk është paguar qira për shfrytëzimin e hapësirës së shkollës dhe po ashtu punët për këtë hapësirës të shkollës për byftë ishin kryer pa mbikëqyrjen e ndonjë komisioni të përbashkët ndërmjet paditësit dhe shkollës, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike , gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale C.nr.701/06 me të cilën është urdhëruar nga gjykata që të lirohet lokalin i datës 07.11.2006, Kërkesa e paditësit adresuar drejtorisë së shkollës Sh.M.T " Mehmet Isai" dhe Këshillit të Shkollës e datës 06.10.2005, Para masa dhe para llogaria e dorëzuar me datën 08.01.2003, dorëzuar paditësit nga pune kryerësi, Procesi i datës 27.12.2002 i përpiluar nga Komisioni i formuar në Ndërmarrjen "Morava e Binqës" nga anëtarët F. A. dhe Sh. S., Kërkesa adresuar shkollës, gjegjësisht Këshillit të Shkollës nga paditësi i datës 14.04.2002, Para masa dhe para llogaria e datës 14.01.2002 me numër të protokolit 968 , adresuar për paditësin M. M. nga punë kryesi, kërkesa e datës 17.11.2006 e M. M. adresuar Sh.M.T "Mehmet Isai", Kërkesa e paditësit adresuar Këshillit të Shkollës e datës 02.11.2003, Kërkesa për rregullimin dhe miratimin e kontratës së byfesë së shkollës e datës 24.12.2014 e paditësit adresuar Drejtorisë dhe Këshillit te shkolles se mesme " Mehmet Isai ", Urdhëresa e Shkolles së Mesme Teknike numër 04-10/1 e datës 26.03.2003 e drejtorit te shkollës I.Sh., Njoftimi i drejtorit të shkollës, adresuar M. M. lidhur me shfrytëzimit e lokalit me numër të protokollit 02-121-/1 i dates 13.07.2004, Njoftimi i Sh.M.T "Mehmet Isai " me numër të protokollit 02-136/1 i datës 13.07.2005, Shkresa për lirimin e podrumit të shkollës numër 04-164/1 e datës 13.09.2005, kërkesa e shkollës së mesme teknike numër 02-168/1 e datës 07.09.2006, Shkresa mbi njoftimin dhe kërkesa e datës 05.09.2006, e SH.M.T "Mehmet Isai " adresuar drejtorit të DKA, A.R. , Shkresa për lirimin e podrumit e Drejtorit të Shkollës I.Sh., adresuar krye shefit të ekzekutivit e datës 11.09.2006, ekspertiza mbi vlerësimin e investimit të materiali elektrik e muajit gusht 2014, me numër C.nr 385/2012 ekspertit Y.Z. , Raporti i ekspertizës i datës 17 korrik 2014 si dhe tenderi intern për renovimin e byfes së shkollës në katin përdhesë të objektit të shkollës e shpallur nga Drejtori i Shkolles I.Sh. i datës 10.01.2002.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësore dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për të cilën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.701/06 të dt.078.11.2006, gjykata vërtetoi faktin se është aprovuar kërkesëpadia e paditëses Shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai" në Gjilan, me të cilën është obliguar i padituri M. M. nga Gjilani që ta lirojë lokalin e të padituris nga sendet dhe personat gjegjësisht podrumin e shkollës në sipërfaqe prej 50m2.

Nga kërkesa e paditësit adresuar Drejtorisë së Shkollës SH.M.T,."Mehmet Isai" dhe Këshillit të Shkollës e datës 06.05.2005, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti fillimisht i është drejtuar , drejtorisë së shkollës lidhur me mundësin e zgjidhjes së këtij problemi.

Nga përmasa dhe para llogaria e dorëzuar më datën 08.01.2003 dorëzuar paditësit nga punë kryesi, gjykata vërtetoi faktin se ky proces është përpiluar më datën 27.12.2002 në komisionin e përbërë nga Ndërmarrja "Morava e Binqës", me anëtarët F. H.dhe Sh. S. si dhe në prezencë të komisionit të shkollës B. M. dhe N. K..

Nga kërkesa adresuar shkollës gjegjësisht Këshillit të Shkollës nga M. M., gjykata vërtetoi faktin se paditësi me anë të kësaj kërkese i është drejtuar Këshillit të Shkollës për verifikimin apo vlerësimin e mjeteve materiale të harxhuara për byfen shkollore.

Nga para masa dhe para llogaria e datës 14.01.2002 me nr.të protokolit 968 gjykata vërtretoi faktin se kjo parallogaritje është bërë në shumën e përgjithshme prej 11,037.90 €.

Nga kërkesa e datës 17.11.2006 gjykata vërtetoi faktin se i njejti me këtë datë i është drejtuar SH.MT."Mehmet Isai" në Gjilan lidhur me ofrimin e këtyre dokumenteve.

Nga kërkesa e datës 02.11.2003 adresuar Këshillit të Shkollë gjykata vërtetoi faktin se paditësi i është drejtuar këtij këshilli me kërkesë për pranimin e investimeve në bufen shkollore.

Nga kërkesa për rregullimin dhe miratimin e kontratës së byfesë së shkollës të dt.24.12.2004 gjykata vërtetoi faktin se paditësi i është drejtuar kësaj drejtorie me qëllim që ofrimit të dokumenteve të mjaftueshme dhe të nevojshme të investimeve që i njëjti i kishte bërë.

Nga fletëparaqitja e datës 01.11.2006 adresuar SH.M.T. "Mehmet Isai" gjykata vërtetoi faktin se drejtori kësaj shkolle ka ushtruar fletëparaqitje ndaj punëtorit M. H. M. , ngase dyshohet se kishte bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes së mësimdhënësit gjegjësisht , nenit 3.1.4.2 dhe 5.1 t të pikës ë (c) dhe (g) të Udhëzimit Administrativ numër MASHT (I)44.2004.

Nga urdhëresa e SH.M.T. Mehmeti Isai" në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se ndaj paditësit është urdhëruar që t'i kryej obligimet ndaj shkollës të mbështetura në kontratën e sipërpërmendur pika IV dhe se afati i fundit i pagesë është data 02.04.2003.

Nga njoftimi lidhur me shfrytëzimin e lokalit afarist i dt.13.07.2005 gjykata vërtetoi faktin se paditësi M. M. është njoftuar nga Këshilli i shkollës që ta liroj lokalin-bufen e shkollës deri më dt.10.08.2005 se për ndryshe do të paditen në Gjykatën Komunale në Gjilan për lirim të lokalit të shkollës.

Nga kërkesa për lirimin e podrumit të shkollës e drejtorit I. Sh. adresuar krye shefit të ekzekutivit më datën 13.09.2005, gjykata vërtetoi faktin se kjo drejtori i është drejtuar Zyrës së Arsimit në Gjilan-Inspektorit të lartë të arsimit në Gjilan për lirimin me dhunë të të njëjtit nga shfrytëzimi i lokalit.

Nga kërkesa e shkollë së mesme teknike nr.02-168/1 të dt.07.09.2006, gjykata vërtetoi faktin se kujdestari i klasës M. R. i ishte drejtuar me kërkesë dhe me nënshkrim të 28 nxënësve për sigurimin e lokalit për mësim meqë 4 ditë kishin bredhur nëpër korridore.

Nga shkresa mbi njoftimin dhe kërkesën e dt.05.09.2006 e Sh.M.T.”Mehmet Isai”, gjykata vërtetoi faktin se drejtori i kësaj shkollë i është drejtuar Drejtorit të DKA në Gjilan lidhur me problemet që i kishte lidhur formimin e komisionit në përbërje prej 3 anëtarëve për vlerësimin profesional për intervenimet e nevojshme në tri hapësira shkollore.

Nga shkresa për lirimin e podrumit të shkollës e drejtorit adresuar krye shefit ekzekutiv të dt.11.09.2006, gjykata vërtetoi faktin se drejtori i kësaj shkolle me kërkesë i është drejtuar krye shefit për lirimin e podrumit të shkollës.

Nga shkresa e datës 10.01.2002 e Drejtorisë së Shkollës të nënshkrua nga drejtori i shkollës I. Sh. gjykata vërtetoi faktin që ishte shpallur tenderi intern për renovimin e bufesë së shkollës në katin përdhese të kësaj shkolle.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave materiale të deponuara në shkresat e lëndës në seancat gjyqësore, dhe vlerësimin e rrethanave me rëndësi për vendosje meritore në këtë çështje, gjykata e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroj të paditurën t’ia kompensoj paditësit dëmin material në emër te investimeve të kryera për renovimin-rregullimin e hapësirës së korridorit të shkollës dhe rregullimin e lokalit afarist për kafe- byfe, në Shkollën e Mesme Teknike “Mehmet Isai” në Gjilan, të llogaritur ne lartesine prej 8.458,90euro, me kamat vjetore që do ti llogaritet në shkallën prej 3.5%, sa paguajnë qytetarët në bankat afariste të Republikës së Kosovës, nga data 06.04.2007 (data e paraqitjes së padisë në gjykatë) e deri në pagesën definitive, këtë ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit te dhunshëm edhe duke u bazuar në dispozitat e LMD-ës, gjegjësisht neni 136 paragrafi 1 e 2, sipas së cilës parashihet se ‘*’Kush i shkakton tjetrit dëmin ka që detyrë ta kompensojë, nëqoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”, ku gjykata ka përfunduar me vërtetimin e gjendjes faktik se SHMT.”Mehmet Isai” në Gjilan me lëshimet e saja , neglizhencën dhe vonesat e saja i ka shkaktuar dëmin material paditësit M. M. nga Gjilani dhe për dëmin e shkaktuar përgjegjësinë e bartë e paditura Komuan e Gjilanit, pasi që ajo i financon të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në territorin e saj.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi duke u mbështetur në Tenderin e dates 10.01.2002 të cilin e kishte shpallur Drejtoria e kësja shkolle të cilin tender e kishte fituar me të gjitha kushte e

ofruara tani paditësi M. M. nga Gjilani, në bazë të së cilës edhe I njejti kishte bërë renovimin e byfesë-podrumit dhe e kishte adaptuar për nevojat e nxënësve dhe të gjithë stafit të shkollës për të cilin edhe kishte investuar në shumën e aprovuar, e caktuar nga eskpertët përkatës.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në mbështetje të nenit 450 të LPK-ës, ashtu që secila pale paraprakisht vet i bart harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta .

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në mbështetje të nenit 7, 8, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN-
Departamenti i Përgjithshë-Divizioni Civil
C.nr.1425/20, datë 25 Qershor 2021

Gjyqtarja,
Mirvete Alidemi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.